

# WORKSHOP: “Bankat dhe Pandemia”

---

Në bashkëpunim me Bankën Kombëtare Tregtare, Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI-t zhvilloi aktivitetin për studentët me temë: “Bankat dhe Pandemia”.

Z. Altin Turhani Drejtor i përgjithshëm i BKT, Dega Elbasan, informoi studentët për paketat-ofertë dhe produktet që ofron BKT sidomos për grupmoshat 12-25 vjeç.



Z. Turhani theksoi se një sfidë shumë e rëndësishme për bankat është edhe siguria e informacionit për të cilën BKT ka investuar fuqishëm. Ashtu si për çdo biznes tjetër edhe për bankat, inovacioni dhe teknologjia janë e ardhmja.

Risia që BKT ka sjellë për konsumatorin është mundësia e depozitimit pranë ATM-ve.



Në pjesën e fundit të aktivitetit në Sesionin e pyetje/përgjigjeve iu la hapësirë studentëve të drejtonin pyetje me interes për ta, ku spikatën sidomos studentët e programeve të studimit Teknologji Informacioni dhe Finacë Kontabilitet.

